

20071061391

## L I G J

### **PËR NGARKIMIN ME BORXH E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKAT NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM - BANKA BOTËRORE ME MARRËVESHJE PËR HUA PËR PROJEKTIN PËR PËRFORCIMIN E BUJQËSISË DHE PËR QASJE**

#### Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet me borxh te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore me hua në shumë prej 15 000 000 euro, dedikuar për realizimin e Projektit për përforcimin e bujqësisë dhe për qasje.

#### Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 të këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua për Projektin për përforcimin e bujqësisë dhe për qasje, i cili lidhet ndërmjet Qeveris së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 të këtij neni do ta nënshkruajë Ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

#### Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 17 vjet, me grejs periudhë prej 5 vjetësh. Shkalla e kamatës sipas së cilës do të servisohet huaja është LIBOR (me euro valutë) plus distanca variabile. Shkalla e kamatës mund të jetë edhe më e vogël varësisht prej vendimeve valide të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Huaja do të paguhet në 24 këste gjysmëvjetore, secila në shumë prej 625 000 euro. Pagesa do të kryhet më çdo 15 shkurt ose 15 gusht të vitit, duke filluar prej 15 shkurt 2013, e duke mbaruar deri më 15 gusht 2024.

Në grejs periudhën prej 5 vjetësh, që paraqet dhe periudhë të realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëtrajtshëm në shumë prej 1% nga shuma e huas, e cila mund të jetë edhe më e vogël varësisht prej vendimeve të vlefshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Për shumën e mjeteve të patërhequra të huas paguhet provizion i përcaktuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në lartësi prej 0,75% në vit, e cila mund të jetë edhe më e vogël varësisht prej vendimeve valide të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Provizioni i mjeteve të patërhequra nga paragrafi 5 të këtij neni paguhet në gjysmëvjetor, më 15 shkurt dhe 15 gusht çdo vit.

#### Neni 4

Për realizimin e Marrëveshjes për huan për Projektin për përforcimin e bujqësisë dhe për qasje nga neni 2 të këtij ligji është kompetente Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave është shfrytëzuese e mjeteve të huas nga neni 1 të këtij ligji.

Neni 5

Huan nga neni 1 të këtij ligj do ta servisojë Republika e Maqedonisë me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.